



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:219163
Datë: 14.07.2022
Numri i dokumentit: 03228389

C.nr.1464/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Durim Balaj, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Sh. nga Gj., të cilin e përfaqëson avokat Fadil Sinanaj nga Gjalani, rruga “Bulevardi i Pavarësisë” H-35, K-2, nr. 4, kundër të paditurit SHSKUK në Gjakovë, rruga “Dëshmorët e Lirisë”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.R. – juriste tek i padituri, për pagesën e shpërblimeve jubilarë, vlera e kontestit 1.977,00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, në të cilin morën pjesë të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me 14 korrik 2022 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Sh. nga Gj. dhe DETYROHET i padituri SHSKUK në Gjakovë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 30 vjet të përvojës së punës, t’ia paguaj shumën prej 1.977,00 (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 30.09.2021, e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269,20 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e njëzetë cent), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit mbi shumën e gjykuar sikurse në pikën I të këtij dispozitivi, dhe atë në shumën prej 123,48 (njëqind e njëzet e tre euro e katërdhjetë e tetë cent).

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 30.09.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurit SHSKUK në Gjakovë, me bazë juridike - kompensim i shpërblimit jubilar. Në padinë e parashtruar ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek i padituri në punët dhe detyrat e punës: Specialist i Biokimisë Klinike ne Laboratorin e SP “Isa Grezda” në Gjakovë, ku aktualisht i ka bërë 30 vite përvojë pune tek i padituri. Ka shtuar se paditësi disa

herë më kërkesë verbale i është drejtuar të paditurit për realizimin e pagesës në raport me shpërblimin jubilar, por deri me tani i njëjti nuk i është përgjigjur, andaj kërkesa e paditësit është e parashtruar konform dispozitave të kontratës kolektive sektoriale në nenin 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të tre pagave mujore dhe atë shumën prej 2,100,48 euro, pasi që një pagë mujore është në shumë prej 700,16 euro. Duke qenë se e paditura nuk e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, i njëjti ka qenë i detyruar që të parashtojë padi në këtë gjykatë.

I autorizuari i paditësit në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj. I njëjti në tërësi e ka kundërshtuar përgjigjen në padi si të pa bazuar. Më tej ka shtuar se gjatë shqyrtimit kryesor është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë, ashtu që nga kontrata e punës është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar tek i padituri. Nga lista e pagës është vërtetuar fakti se i njëjti realizon pagë mujore 700,16 euro, andaj ka kërkuar nga gjykata që në tërësi të e aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, bazuar në nenin 17 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, ashtu që në rastin konkret të e detyrojë të paditurin që paditësit t'ia paguaj kompensimin e shpërblimit jubilar në shumë prej 2,100.48 euro, në vlerë të tre pagave mujore, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet procedurale, i ka kërkuar dhe atë: shumën prej 30,00 euro e cila referohet taksës gjyqësore të paguar për padi, shumën prej 104,00 euro e cila shumë i referohet përpilimit të padisë, si dhe shumën prej 135,20 euro për përfaqësim në seancën kryesore.

I padituri në përgjigje në padi të parashtruar në këtë gjykatë me 16.11.2021, ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se me Ligjin e Punës, nuk është paraparë kompensimi i shpërblimeve jubilarë. Po ashtu bazuar në nenin 2 të kontratës kolektive sektoriale të lidhur me datë 11.06.2018 Afati i zbatimit të kësaj kontrate është në kohëzgjatje prej 3 vjet nga data e nënshkrimit nga palët në këtë kontratë që do të thotë se padia për pagesën e shpërblimeve jubilarë e bere nga paditësi me dt.30.09.2021 është jashtë afatit kohor të caktuar me këtë kontratë kolektive, dhe si e tillë është e pasafatshme. Po ashtu ka theksuar se nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, nuk është paraparë vija buxhetore për këtë kategori, prandaj në mungesë të linjës buxhetore, përkatësisht të mjeteve i padituri nuk ka mundësi objektive për t'a përmbushur obligimin e kompensimit të pagave jubilarë, për faktin se veprimi në drejtim të kompensimit të pagave jubilarë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2021. Me propozim për gjykatën që t'a refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë.

E autorizuar e të paditurit gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, pasi që në këtë kërkesë të paditëses është përfshirë edhe shujta, ashtu që vlera duhet të bazohet vetëm në pagën bazë, pa përfshirë shtesat tjera të lartcekura, pasi që me nenin 55 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, është paraparë se të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin

në pagë dhe të ardhurat tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin, për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë. Me propozim që gjykata të e refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, si të pabazuar.

Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: kontratën e punës, në kohë të caktuar, me nr. të prot. 2742, datë 05.11.2019, e lidhur në mes të paditëses dhe këtu të paditurit; si dhe listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 01.06.2021 – 31.06.2021; si dhe vërtetimin nga marrëdhënia e punës, datë 10.08.2021.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga provat e zbatuara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Me kontratën e punës me nr. prot. 2742, datë 05.11.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësi ka lidhur kontratë pune me të paditurin Spitali Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me detyrat e punës: Specialist i Biokimisë Klinike, duke filluar nga data 23.10.2019.

Nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 01.07.2020 – 31.07.2020, vërtetohet fakti se këtu paditësi ka 30 vite provoj pune dhe realizon pagë bazë mujore në lartësi prej 659,00 euro.

Nga vërtetimi i marrëdhënies së punës, datë 10.08.2021, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë është provuar rrethana se paditësi është i punësuar tek i padituri Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, si Specialist i Biokimisë Klinike, prej datës 26.01.2004 e tutje, si dhe i njëjti i ka 30 vite provoj pune.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi është i punësuar tek i padituri për më shumë se 30 vjet, e që prej kohës kur i ka mbushur 30 vjet përvojë pune, të njëjtit nuk i është bërë pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të tre pagave mujore, të paraparë me nenin 17 par. 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e kësaj page e ka pohuar edhe i padituri përmes përgjigjes në padi, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë vendosi duke ju referuar Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3, është paraparë se: *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga*

punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page mujore të tij". Përvojën e punës dhe lartësinë e pagës bazë së paditësit, gjykata e vërtetojë nga lista e pagave, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, andaj edhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke ia njohur shumën prej 1,977.00 euro.

Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht kërkesën e paditësit dhe atë në shumë prej 123,48 euro, pasi që erdhi në përfundim së paga mujore bazë (pa shtesa) e paditësit është saktësisht 659,00 euro, bazuar në listën e pagave të administruar në këtë shqyrtim.

Gjykata vlerëson së paga mujore me shtesat tjera të paraqitura në listën e pagave dhe atë pagesa e shujtave, nuk mund të jenë objekt përfitimi nga paditësi, pasi që legjislacioni aktual i punës ka bërë dallimin e pagës dhe shtesave tjera në punë. Me nenin 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, është paraparë se *"Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës"*. Pra përcaktimi ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë dhe shtesa nga paga. Në anën tjetër, me nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3 i Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, parashihet se i punësuari ka të drejtën e realizimit të tre pagave mujore, e që nuk i përfshinë shtesat tjera nga paga.

Në nenin 17 paragrafi 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë parashihet se *"Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf"*. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, i njëjti është i legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e padituri, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse i padituri rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se *"Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*. Rrjedhimisht, duke qenë se i padituri i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që t'a detyroj të paditurin që paditësit t'ia kompensoj shumën e gjykuar në pikë I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurit të dhënë në përgjigje në padi, ku ka pretenduar se padia është e pasafatshme, mirëpo ky pretendim ishte i pabazuar, për shkak se paditësi në kohën e paraqitjes së padisë, ka pasur të arritur përvojën e punës prej 30 vitesh, siç është vërtetuar nga vërtetimi mbi marrëdhënien e punës, si dhe nga lista e pagave e administruar përgjatë shqyrtimit kryesor.

Po ashtu, i pabazë ishte edhe pretendimi i të paditurës lidhur me atë së e paditura nuk ka linje buxhetore për kompensimin e këtij kompensimi për punëtorët shëndetësor, për shkak së me nënshkrimin e kontratës kolektive sektoriale të shëndetësisë, i padituri ka marrë obligim që të bëjë kompensimin e këtyre pagave, e po ashtu ka obligim me kohë të planifikoj buxhetin me

kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka paraparë linjë buxhetore për këtë lloj të kompensimit, ashtu që të njëjtat nuk patën ndikim për të vendosur ndryshe në këtë rast.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç'rast paditësit iu pranua shuma e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 269,20 euro. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 30,00 euro (sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 euro, si dhe përfaqësim në një seancë gjyqësore 135,20 euro (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1464/21, me 14 korrik 2022

GJYQTARI,
Durim Balaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.